



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.22, datë 03.10.2018

PËR

MIRATIMIN E SHTYRJES SË AFATIT TË LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“NDËRTIMI I STACIONIT GJIROKASTRA CENTER 1571”, BASHKIA
GJIROKASTËR

Në mbështetje të neneve 27, 28 dhe 40, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të shoqërisë “Telekom Albania” sh.a, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e shtyrjes së afatit të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Ndërtimi i stacionit Gjirokastra Center 1571”, Bashkia Gjirokastër, me subjekt zhvillues shoqërinë “Telekom Albania” sh.a., miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 14, datë 29.12.2016, me subjekt zhvillues shoqërinë “Telekom Albania” sh.a.
2. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
EDI RAMA



